



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare
Generalni Savet Socijalnih i Porodičnih Usluga
General Council of Social and Family Services



MODULI MBI LEGJISLACIONIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Maj 2023

Ky publikim përkrahet nga KOMF, në kuadër të projektit “Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cënueshme në Kosovë”, i cili mbështetet nga UNICEF në Kosovë në partneritet me USAID.

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në kuadër të këtij moduli trajnues janë të ekspertëve të angazhuar nga KOMF, dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF në Kosovë apo të USAID në Kosovë.

Autor: Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
I. Legjislacioni i Shërbimeve Sociale dhe Familjare.....	11
II. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	12
III. Instrumentet Kryesore Juridike Ndërkombëtare që Rregullojnë Fushën e Shërbimeve Sociale dhe Familjare.....	13
IV. Ligjet Kryesore të Republikës së Kosovës për Shërbime Sociale dhe Familjare	18
V. Korniza Ligjore në Kosovë që Rregullon Kontraktimin/Komisionimin e Shërbimeve Sociale.....	25
VI. Aktet Nënligjore kryesore me të cilat rregullohet fusha e shërbimeve sociale dhe familjare	27
ANEKSET	31
A) Raste studimi	31
B) Agjenda.....	32
C) Burimet e referimit.....	33
D) Vlerësim trajnimi	34

HYRJE

Fusha e shërbimeve sociale dhe familjare përfshin një gamë të gjerë shërbimesh multi disiplinare dhe multi sektoriale, të cilat u ofrohen fëmijëve dhe personave të rritur në nevojë sociale, pasi secili individ si subjekt i së drejtës, por edhe si pjesë e familjes dhe komunitetit, në situata dhe rrethana të caktuara të jetës ka nevojë për përkrahje dhe mbështetje me qëllim të tejkalimit të vështirësive apo sfidave me të cilat përballet. Këto sfida dhe vështirësi mund të jenë të intensitetit të tillë që shkaktojnë pasoja tek individit apo familja, e të cilat mund ta përcjellin atë gjatë gjithë jetës. Andaj është e rëndësishme që të gjithë, duke filluar nga familja, komuniteti, institucionet publike dhe private, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile, të ofrojnë mbrojtjen e nevojshme me fokus në parandalim, dhe aty ku kërkohet, edhe rehabilitim dhe reintegrim të tij apo saj në shoqëri, përmes ofrimit të shërbimeve sociale të integruara varësisht nga nevoja e individit apo familjes.

Familja, duke qenë njësi themelore e shoqërisë dhe e mjedisit jetësor, ka përgjegjësi primare për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës, e gjithashtu edhe të shtresave të tjera të individëve që për një arsye apo tjetër, gjinden në nevojë të përkohshme apo të përhershme për marrje të shërbimeve sociale dhe familjare. Familja duhet të sigurojë që secili anëtarë i saj, e në veçanti fëmija, të zhvillohet dhe jetojë në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi, e cila nxit zhvillimin e potencialit të plotë të secilit anëtar të familjes, me theks të veçantë fëmijës.

Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes duhet të mbrojnë jetën dhe zhvillimin e fëmijës, si dhe të respektojnë dinjitetin, vlerat dhe personalitetin e fëmijës, e gjithashtu edhe të personave të tjerë që jetojnë në bashkësinë familjare. Vëmendje e shtuar i duhet dhënë shtresave të marxhinalizuara të shoqërisë siç janë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar dhe kategoritë e tjera në nevojë sociale. Shërbimet sociale dhe familjare duhet ti ofrohen secilit person i cili është në nevojë për shërbime sociale.

Me qëllim të mbrojtjes së jetës, ofrimit të kujdesit si dhe sigurimit të mirëqenies së fëmijëve dhe personave të tjerë në nevojë, legjislacioni ka përcaktuar forma dhe shërbime të shumta sociale dhe familjare, të cilat mund dhe duhet tu ofrohen atyre, nëpërmjet të cilave sigurohet dhe ofrohet mbrojtja efektive. Ato shërbime tanimë janë të normuara në Kushtetutë, Instrumente Ndërkombëtare, ligje, si dhe në akte nënligjore dhe standarde minimale, ku shumica e tyre ofrohen si pjesë e shërbimeve të kombinuara juridike dhe sociale që u ofrohen fëmijëve dhe personave të tjerë në nevojë.

Këto forma të mbrojtjes sociale, si pjesë e përgjithshme e shërbimeve sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për kategori të ndryshme (të fëmijëve dhe të rriturve) në nevojë për mbrojtje sociale, siç përcaktohen në Ligjin përkatës për Familjen, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, si dhe ligjet e tjera të veçanta.

Format e mbrojtjes sociale dhe familjare, si dhe shërbimet sociale, përfshijnë aktivitete, masa dhe programe të destinuara për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen, rehabilitimin, reintegrimimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe vështirësive të fëmijëve dhe personave të tjerë në nevojë sociale, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

SHKURTESA

MPMS	Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ¹
MD	Ministria e Drejtësisë
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
KPSHSF	Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare
TMNMR	Tryezat Multidisplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit
QPS	Qendra për Punë Sociale
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
LMF	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
LFK	Ligji për Familjen i Kosovës
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KDFKB	Komiteti i të Drejtave të Fëmijës i Kombeve të Bashkuara
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ²

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe numri	Legjislacioni i shërbimeve sociale dhe familjare	Nr. 3
Qëllimi	Vijuesit e këtij moduli do të marrin njohuritë bazë sa i përket aspektit legjislativ dhe institucional vendor që e rregullon fushën e shërbimeve sociale dhe të familjes.	
Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë	20 orë mësimore, 1 kredi ECVET	
Kërkesat për qasje në modul	Moduli është obligativ për kualifikimin përkatës por mund të zgjidhet po ashtu si trajnim i veçantë për tu ndjekur.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit		
RM1. Kandidati përshkruan bazën e legjislacionit mbi të drejtën sociale dhe familjare në vendin tonë, aspekti kushtetues dhe aspekti i rregullimit përmes konventave ndërkombëtare.		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathhtësitë dhe kompetencat	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> E drejta sociale dhe e familjes nga aspekti Kushtetues i RKS. E drejta sociale dhe e familjes nga aspekti i rregullimit përmes konventave ndërkombëtare. E drejta sociale dhe e familjes në aspektin e rregullimit përmes ligjit dhe akteve nënligjore në vendin tonë. 	<p>Testimi..... 60%</p> <p>Kontributi në debat..... 20%</p> <p>Rast studimor20%</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Vijuesi i trajnimit duhet të ndjekë ligjëratat min. 80% të kohës, të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në punën në grupe, ta dorëzojë detyrën/ punimin/ me kohë.</p> <p>Njohuritë që fitohen nga ky modul trajnimi:</p> <p>Baza ligjore dhe organizimi institucional që e rregullon fushën e shërbimeve sociale dhe të familjes. Vlerësimi me kompetencë për t'u marrë me raste që aplikojnë për shërbime sociale nga shteti.</p> <p>Shkathhtësitë e fituara nga ky modul trajnimi:</p> <p>Përforsim dhe freskim i njohurive të punës. Aftësi për të vepruar dhe ndihmuar njerëzit që kanë nevojë, në secilën rrethanë, bazuar në ligje dhe akte nënligjore.</p> <p>Kompetenca profesionale pas këtij trajnimi:</p> <p>Autonomi e plotë për veprim, Siguri dhe përgjegjësi mandatore/ ligjore/, Vlerësim korrekt ndaj rasteve që merret, Monitorim i punës me secilin rast që merret.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje për të verifikuar shkallën e përvetësimit të njohurive dhe reflektimin mbi modulin. Detyra me shkrim për rastin studimor duhet të jetë unik edhe ti referohet njohurive mbi modulin.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit
RM2: Kandidati përshkruan bazën e legjislacionit mbi të drejtën sociale dhe familjare në vendin tonë, të drejtat e fëmijëve dhe personave në nevojë, nga aspekti kushtetues, i konventave ndërkombëtare, i ligjeve dhe akteve nënligjore në vend.

Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> Të drejtat e fëmijëve dhe personave në nevojë nga aspekti Kushtetues i RKS. Të drejtat e fëmijëve dhe personave në nevojë nga aspekti i rregullimit përmes konventave ndërkombëtare. Të drejta e fëmijëve dhe personave në nevojë në aspektin e rregullimit përmes ligjit dhe akteve nënligjore në vendin tonë. 	<p>Testimi..... 60% Kontributi në debat..... 20% Rast studimor20%</p> <p>Kriteret e vlerësimit: Vijuesi i trajnimit duhet të ndjekë ligjëratat min. 80% të kohës. Të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në punën në grupe. Ta dorëzojë detyrën/ punimin/ me kohë.</p> <p>Njohuritë që fitohen nga ky modul trajnimi: Baza ligjore dhe organizimi institucional që rregullon fushën e të drejtave të fëmijëve dhe personave në nevojë. Kandidati do të marrë njohuritë bazë mbi vlerësimin e rasteve të cilët aplikojnë për përfitimin apo mbikëqyrjen sociale dhe familjare që shteti ofron. Po ashtu duke ilustruar dhe trajtuar modele të ndryshme nga aspekti teorik dhe praktik, kandidatët pajisen me aftësi analitike dhe të vendosjes sipas kompetencave ligjore për të ofruar zgjidhje ndaj rasteve që paraqiten pranë administratës shtetërore në nivel lokal e qendror.</p> <p>Shkathtësitë e fituara nga ky modul trajnimi: Freskim i njohurive të punës. Aftësi për të vepruar dhe ndihmuar fëmijët dhe të gjithë personat që kanë nevojë, në secilën rrethanë, bazuar në ligje dhe akte nënligjore.</p> <p>Kompetenca profesionale pas këtij trajnimi: Autonomi e plotë për veprim. Monitorim me kujdes i secilit rast. Siguri dhe përgjegjësi mandatore / ligjore. Vlerësim korrekt ndaj rasteve të trajtuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje për të verifikuar shkallën e përvetësimit të njohurive dhe reflektimin mbi modulin. Detyra me shkrim për rastin studimor duhet të jetë unike dhe t'i referohet njohurive mbi modulin.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit
RM3: Kandidati përshkruan bazën e organizimit institucional dhe mekanizmave të tjerë sipas legjislacionit mbi të drejtën sociale dhe familjare në vendin tonë.

Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> Mekanizmat institucion- al që ofrojnë shërbimet sociale dhe familjare në vendin tonë. 	<p>Testimi..... 60%</p> <p>Kontributi në debat..... 20%</p> <p>Rast studimor20%</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Vijuesi i trajnimit duhet të ndjekë ligjëratat min. 80% të kohës.</p> <p>Të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në punën në grupe. Ta dorëzojë detyrën/ punimin/ me kohë.</p> <p>Njohuritë që fitohen nga ky modul trajnimi:</p> <p>Njohja me mekanizmat institucional (shtetëror dhe delegates nga shteti, pra OJQ) që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.</p> <p>Identifikimi i secilit mekanizëm që ofron shërbime sociale e shëndetësore nivel qendror dhe nivel lokal. Baza ligjore dhe nënligjore me të cilën funksionojnë OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale e shëndetësore.</p> <p>Shkathtësitë e fituara nga ky modul trajnimi:</p> <p>Aftësi për të vepruar dhe ndihmuar të gjithë personat që kanë nevojë, në secilën rrethanë, bazuar në ligje dhe akte nënligjore.</p> <p>Kompetenca profesionale pas këtij trajnimi:</p> <p>Monitorimi i punës së secilit mekanizëm shtetëror apo OJQ mbi realizimin e punës së tij sipas ligjit për secilin rast që paraqitet.</p> <p>Siguri dhe përgjegjësi mandatore / ligjore.</p> <p>Vlerësim korrekt ndaj rasteve të trajtuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje për të verifikuar shkallën e përvetësimit të njohurive dhe reflektimin mbi modulin. Detyra me shkrim për rastin studimor duhet të jetë unike dhe t'i referohet njohurive mbi modulin.

Literatura
për modulin:

Magna Carta Libertatum 1215 ne Angli;
https://sq.wikipedia.org/wiki/Magna_Carta
 Deklarata Universale mbi te Drejtat e Njeriut, 1948, Paris;
<https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Univer-sale%20e%20te%20Drejtave%20te%20Njeriut%20%281948%29.pdf>
 Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
 Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare 2007 dhe P/N 2012;
<https://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=LIGJI%20PER%20SHER-BIME%20SOCIALE&so=1>
 UA (MPMS) 03/2020 për Licencimin e OJQ-ve në Fushën e Shërbimeve So-ciale në Nivel Profesional;
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36042>
 UA (MPMS) 01/2020 - për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare të Nivelit Bazik, të Mesëm dhe të Lartë;
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=36035>
 Konventa e UNICEF mbi të Drejtat e Fëmijëve;
<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpubli-cation505.pdf>

KONTRIBUTI NË NGARKESËN E KANDIDATIT

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4 orë	2 ditë	8 orë
Rast studimor	4 orë	2 ditë	8 orë
Vetëstudim i kandidatit	1 orë	2 ditë	2 orë
Vlerësim dhe testim	2 orë	1 ditë	2 orë
Totali	20	3 ditë	20 orë—1 kredi (ECVET)

I. LEGJISLACIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Ky Modul i trajnimit është zhvilluar duke u bazuar në legjislacionin e aplikueshëm (parësor dhe dytësor), ku përfshihen Kushtetuta, Konventat dhe Instrumentet tjera të rëndësishme ndërkombëtare që rregullojnë aspektet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të personave të rritur në nevojë sociale.

Korniza legislative për shërbime sociale dhe familjare në Republikën e Kosovës - Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovës, pas Kushtetutës bazohet edhe në Konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, disa prej të cilave që janë të numëruara taksativisht në bazë të nenit 22 të Kushtetutës, zbatohen drejtpërdrejtë në Kosovë dhe kanë epërsi mbi ligjet vendore. Sa i takon Konventave dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare që nuk janë të zbatuara drejtpërdrejtë në Kosovë, me rastin e hartimit të ligjeve, legjislacioni i Kosovës gjithmonë hartohet në pajtim me parimet e përgjithshme të tyre, për aq sa ka mundësi të gjejnë zbatim në Kosovë, pasi që në procesin e integritimeve europiane dhe në organizatat e ndryshme ndërkombëtare siç është Këshilli i Europës, kërkohet një gjë e tillë. Disa nga Konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, si dhe disa nga ligjet më të rëndësishme që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, janë si vijon:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)
- Karta Europiane Sociale
- Korniza Europiane Vullnetare e Cilësisë për Shërbimet Sociale
- Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijës
- Ligji i Familjes (Ligji nr.2004/32)
- Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe Ligji Nr. 04/L-081
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr. 03/L-040)
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji nr. 06/L-084)
- Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale (Ligji nr. 2003/15)
- Ligji për Mbështetjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, (Ligji nr. 03/L-22), etj.

II. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - e definon Kosovën si shtet i cili *"bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, të drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe të ekonomisë së tregut"* (neni 7). Gjithashtu me Kushtetutë parashihet zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtave dhe lirive të parapara me Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj dhe të njëjtat kanë prioritet, në rast konflikti ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (neni 22). Më tepër kujdes i është kushtuar barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi, se sa çështjeve të drejtësisë sociale dhe shtetit të mirëqenies. Në nenin 50 janë paraqitur të drejtat e fëmijës (*fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre, fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë, secili fëmijë gëzon të drejtën për tu mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi, të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik apo institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve dhe secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës*). Ndërkaq, neni 51 i Kushtetutës vetëm thekson se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj, dhe se *sigurimi social themelor që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë*, rregullohet me ligj. Në të vërtetë, në Republikën e Kosovës sistemi legjitimohet me vlerat tipike liberale, për dallim nga rajoni, i cili edhe më tej kultivon traditat europiane të social-demokracisë. Kur kemi të bëjmë me organizatat jo qeveritare dhe me iniciativat qytetare, neni 44 i Kushtetutës garanton lirinë e asociimit, e cila ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Çështja e themelimit dhe punës së organizatave jo qeveritare detajisht është rregulluar me Ligjin për Lirinë e Bashkimit në Organizatat Jo Qeveritare (Ligji nr. 04/L-057), ku edhe në fushën e shërbimeve sociale, organizatat jo qeveritare kanë rol dhe rëndësi jashtëzakonisht të madhe në ofrimin e shërbimeve sociale.

III. INSTRUMENTET KRYESORE JURDIKE NDËRKOMBËTARE QË RREGULLOJNË FUSHËN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

- Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut: njeh të drejtën e çdo qenieje njerëzore për të patur zotësi juridike dhe njohjen e tij në çdo vend dhe në çdo kohë. E drejta e jetës dhe e drejta për të gëzuar shëndet të mirë janë parime të njohura nga Deklarata. Për më tepër, kjo deklaratë njeh nevojën dhe ofrimin e shërbimeve sociale për të gjithë individët që janë në nevojë *“Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë, për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij”³.*
- Konventa për të Drejtat e Njeriut: njeh të drejtat elementare të njeriut dhe përcakton detyrimin e shteteve për mbrojtjen e tyre sipas ligjeve kombëtare.

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike: neni 24 i Paktit përcakton se *“Çdo fëmijë, pa asnjë dallim të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri apo lindje, ka të drejtë të ketë masat e atilla të mbrojtjes që kërkon gjendja e tij si i mitur nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit, të cilët duhet të marrin masa për këtë qëllim”.*

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁴: përcakton se familjes, si grupi natyror bazë i shoqërisë, *“duhet t’i sigurohet mbrojtje dhe asistencë maksimale, për aq kohë sa ajo është përgjegjëse për rritjen e fëmijëve”⁵. ‘Masa të posaçme të mbrojtjes dhe ndihmës duhet të merren në të mirë të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, pa kurrfarë diskriminimi për shkaqe përkatësie ose për shkaqe të tjera. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të mbrohen kundër shfrytëzimit ekonomik e shoqëror. Punësimi i tyre në punët e dëmshme për moralin ose shëndetin e tyre, të rrezikshme për jetën ose të dëmshme për zhvillimin e tyre normal, duhet dënuar me ligj. Shtetet duhet gjithashtu të caktojnë afate moshe nën të cilat do të ndalohet dhe do të dënohet me ligj shfrytëzimi me pagesë i fuqisë punëtore të moshës fëmijërore”⁶. Qëllimi i këtij pakti dhe objektivat që ai vendos për shtetet palë, është ulja e vdekshmërisë gjatë lindjes dhe të vdekshmërisë foshnjore, si dhe zhvillimi i shëndetshëm i fëmijës, përmirësimi i të gjitha aspekteve të higjienës së mjedisit dhe të higjienës industriale, si dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për t’u siguruar të gjithëve shërbime mjekësore dhe ndihmë mjekësore në rast sëmundjeje.*

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës: Konventa për të Drejtat e Fëmijës si instrumenti kryesor ndërkombëtar që përcakton të drejtat e fëmijës, në disa nene parashikon mbrojtjen e fëmijës nga format që cenojnë jetën dhe integritetin e tij/saj.

Në preambulën e saj, në dy pjesë përcakton rëndësinë e kujdesit ndaj fëmijës: “Duke kujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë” dhe “Duke pasur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës, fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale, ka

nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”.

Menjëherë pas preambulës, janë dy nene (3 dhe 5) të cilat përcaktojnë obligime dhe përgjegjësi për institucionet, për të ndërmarrë veprime që i garantojnë fëmijës në nevojë mbrojtje nëpërmjet kujdesit qoftë nga familja apo edhe vetë kujdestarët ligjorë të caktuar për këtë qëllim.

Neni 20 konsiston në ofrimin e kujdesit për fëmijët, të cilët për shkaqe të caktuara kanë humbur përkohësisht apo në mënyrë të përhershme kujdesin e prindërve, *si vijon: “1. Një fëmijë, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti. 2. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në pëpëthje me legjislacionin e tyre të brendshëm. 3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, inter alia, formën e vendosjes në një familje, të “Kafalasë” sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevoje, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore”.*

- Karta Europiane Sociale: Karta është një traktat i Këshillit të Europës që garanton të drejtat themelore sociale dhe ekonomike si homologe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila u referohet të drejtave civile dhe politike. Ajo garanton një gamë të gjerë të të drejtave të përditshme të njeriut në lidhje me punësimin, strehimin, shëndetin, arsimin, mbrojtjen sociale dhe mirëqenien.

Karta vë theks të veçantë në mbrojtjen e personave të cenueshëm si pleqtë, *fëmijët*, personat me aftësi të kufizuara dhe migrantët. Ajo kërkon që gëzimi i të drejtave të sipërpërmendura të garantohet pa diskriminim.

Asnjë instrument tjetër ligjor në nivel pan-europian nuk mund të sigurojë një mbrojtje kaq të gjerë dhe të plotë të të drejtave sociale sa ajo e parashikuar nga Karta, e cila shërben edhe si pikë referimi në të drejtën e Bashkimit Europian. Shumica e të drejtave sociale në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, bazohen në nenet përkatëse të Kartës.

Prandaj, Karta shihet si Kushtetuta Sociale e Europës dhe përfaqëson një komponent thelbësor të arkitekturës së të drejtave të njeriut të kontinentit Europian⁷.

- *Korniza Europiane Vullnetare e Cilësisë për Shërbimet Sociale*: Në vitet e fundit, cilësia e shërbimeve sociale është bërë një prej temave më të diskutuara të sektorit të shërbimit social të Bashkimit Europian. Komiteti i Mbrojtjes Sociale i Këshillit të Bashkimit Europian nxori një *“Kornizë Europiane Vullnetare të Cilësisë për Shërbimet Sociale” (2010), që në veçanti i referohet shërbimeve thelbësore të ofruara drejtpërdrejtë për përfituesit⁸”.*

Kjo kornizë synon të zhvillojë një kuptim të përbashkët të cilësisë së shërbimeve sociale dhe përcakton elementet e përgjithshme dhe parimet e cilësisë së shërbimeve sociale. Për më tepër, Korniza e Cilësisë synon që të ndihmojë autoritetet publike përgjegjëse për organizimin dhe financimin e shërbimeve sociale që të zhvillojnë në nivel të përshtatshëm mjetet specifike për përcaktim, matje dhe

⁷Teksti në lidhje me Kartën Europiane Sociale, është kopjuar dhe përkthyer nga faqja e internetit: <https://www.coe.int/en/web/european-social-charter>.

⁸<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1169&langId=en>.

vlërësim të cilësisë së shërbimit social.

Në forume të ndryshme të Bashkimit Europian, përsa i takon mirëqenies sociale në vendet e BE-së, i kushtohet shumë vëmendje aspektit të cilësisë në ofrimin e shërbimeve sociale, meqenëse ajo është konsideruar si një çështje me rëndësi të madhe.

Një aspekt që konsiderohet shumë i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të shërbimeve sociale cilësore, është përfshirja e sektorit privat dhe atij jo qeveritar në ofrimin e shërbimeve. Në shumicën e shteteve të rajonit dhe në Europë tashmë janë formuar mekanizmat formalë që rregullojnë rolin e sektorit privat dhe atij jo qeveritar si partner të mirëfilltë të qeverisë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Kudo, shtetet në BE janë duke u përpjekur që të promovojnë pjesëmarrjen e OJQ-ve në sektorin e shërbimeve sociale duke përfshirë OJQ-të në ofrimin e programeve të shërbimeve të ndryshme sociale në nivel lokal, p.sh. Strehimore të viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore, qendrat e kujdesit ditë dhe qendrat e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbimet e bazuara në familje dhe në komunitet për grupet e cenueshme të popullatës, etj.

Mbështetja e qeverive për organizatat jo qeveritare për të ofruar shërbime sociale, është një praktikë e zakonshme dhe gjithnjë në rritje në vendet anembanë botës. Në të vërtetë, në vendet më të përparuara, mbështetja e tillë është aq e përhapur sa që qeveria është bërë burimi kryesor i mbështetjes financiare të OJQ-ve. Kjo si rezultat i rritjes së numrit të personave/familjeve në nevojë, zgjerimit të gamës së shërbimeve sociale, ndryshimeve në mekanizmat drejtues dhe decentralizimit.

Është e dukshme kudo në literaturë thirrja për formimin e një zinxhiri të profesionistëve dhe ofruesve për të marrë përsipër kujdesin bazuar në nevoja individuale dhe për të ofruar zgjidhje në mënyrë të integruar dhe të koordinuar. Rrjetëzimi, bashkërendimi dhe integrimi ndërmjet tyre shihet si çelësi i ngritjes së cilësisë së shërbimeve sociale.

Një gjë tjetër e rëndomtë në tërë Europën është fakti se shërbimet sociale janë të ndërlidhura ngushtë me shërbimet shëndetësore. Kjo është bërë e dukshme në fushat e kujdesit afatgjatë, rehabilitimit, kujdesit për personat me aftësi të kufizuara, shërbimeve për të varurit nga droga dhe shërbimeve për personat e pastrehë.

Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijës: Udhëzuesit për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve ("Udhëzuesi")⁹ janë të pranuar ndërkombëtarisht si parime dhe rregulla që ofrojnë orientim për shtetet dhe palët e interesuara. Nëpërmjet tyre synohet:

Garantimi se fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për ta humbur atë, janë të mbrojtur në mënyrë adekuate;

Mbështetja me qëllim të parandalimit të ndarjes së panevojshme të familjes; si dhe

Vendosja e standardeve të duhura.

⁹ Miratuar me Rezolutën 64/142 të OKB-së në seancën e gjashtëdhjetë e katërt. 24 shkurt 2010.

Udhëzuesi për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve është një dokument i Kombeve të Bashkuara, i cili u hartua nga autoritetet qeveritare, organet e Kombeve të Bashkuara dhe OJQ-të, në konsultim me fëmijë dhe të rinj. Përkundër faktit që rregullat e përcaktuara në udhëzues nuk janë të karakterit detyrues për shtetet, ato shërbejnë si dokument udhëzues i cili na ndihmon në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe të instrumenteve të tjera ndërkombëtare në kuptimin e rolit të familjes biologjike si dhe në kuptimin e formave të kujdesit alternativ, atëherë kur fëmija nuk ka kujdesin e prindërve dhe të familjes.

Udhëzimet po ashtu kanë për qëllim të përmirësojnë zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe të dispozitave përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, në lidhje me mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve të cilëve u është hequr kujdesi prindëror ose që janë në rrezik. Udhëzimet synojnë të sigurojnë që së pari, fëmijët të mos e gjejnë veten në kujdesin jashtë familjes në mënyrë të panevojshme, dhe së dyti, që lloji dhe cilësia e kujdesit të ofruar jashtë familjes të jetë e përshtatshme për të drejtat dhe nevojat specifike të fëmijës.

- *Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Adoptimin Ndërkombëtar (Konventa e Hagës)* - Konventa e Hagës e vitit 1993 është nxjerrë si një përgjigje ndaj rregullave dhe kërkesave të përcaktuara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, për të nxjerrë dhe adoptuar marrëveshje shumë palëshe në lidhje me adoptimin ndërkombëtar.

Për adoptimin e fëmijëve me shtetësi të Kosovës nga adoptues me shtetësi të huaj, përveç ligjit të brendshëm në fuqi është i zbatueshëm edhe akti ndërkombëtar, siç është Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptim ndërkombëtar, që njihet si Konventa e Hagës. Sipas LFK, adoptimi i fëmijës me shtetësi të Kosovës nga shtetasi i huaj, lejohet vetëm nëse nuk mund të adoptohet në Kosovë, pra në pamundësi të gjetjes së familjes adoptuese në Kosovë, ndërsa kjo rrethanë duhet të konstatohet nga organi shtetëror.

Angazhimet për gjetjen e familjes në shtetin e origjinës për adoptim, kërkohen edhe me Konventë, e nëse nuk gjendet familja brenda në Kosovë, atëherë mund të konsiderohet adoptimi nga shtetasi i huaj. Përveç këtij kushti, është edhe kushti i interesit më të lartë të fëmijës. Konventa e Hagës ka kërkuar që shtetet anëtare të sigurojnë që adoptimi ndërkombëtar bëhet për interesin më të mirë të fëmijës dhe në përputhje me të drejtat e tij/saj themelore të njohura me të drejtën ndërkombëtare (neni 1 pika a). Kemi edhe situatën tjetër kur fëmija që adoptohet ka nevoja të veçanta shëndetësore, e të cilat nuk mund të plotësohen në Kosovë. Fjala është për situatën kur adoptimi në Kosovë mund të bëhet, por fëmija ka nevojë për një trajtim dhe përkujdesje të veçantë shëndetësore, e cila nuk mund të plotësohet nga familja potenciale për adoptim në Kosovë, sikundër që nuk mund të trajtohet nga institucionet shëndetësore vendore.

Konventa ka obliguar shtetet anëtare që të krijojnë një sistem të bashkëpunimit midis shteteve, për të siguruar që të arrihet qëllimi i adoptimit (krijimi i një marrëdhënieje të përhershme prindër-fëmijë), dhe të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve. Konventa, por edhe ligji vendor ka normuar se tek adoptimi ndërkombëtar është i nevojshëm të sigurohet pëlqimi i organit shtetëror. Gjithashtu Konventa ka përcaktuar edhe kompetencën, sipas të cilës kompetent për adoptim të fëmijës është shteti i origjinës, sikundër edhe ka përcaktuar kushtet për adoptim, si për shtetin e origjinës ashtu edhe për shtetin pritës.

Nisur nga Konventa e Hagës, vendi ynë sipas LSHSF, me plotësime dhe ndryshime, ka themeluar një Panel (komision), detyra e të cilit është që të koordinojë aktivitetet për fëmijët pa kujdes prindëror, që kanë të bëjnë me strehimin dhe adoptimin, si brenda vendit, ashtu edhe për atë ndërkombëtar. Në bazë të LSHSF është nxjerrë edhe Udhëzimi Administrativ për themelimin e Panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe adoptim.

- *Konventa Europiane për Adoptimin e Fëmijës (e Këshillit të Europës)* - Është aprovuar fillimisht në vitin 1967 dhe është rishikuar në vitin 2008. Kjo Konventë synon të harmonizojë përmbajtjen e ligjeve mbi adoptimin, duke siguruar që ligjet e shteteve anëtare janë në përputhje me parimet e përbashkëta dhe praktikrat në lidhje me adoptimin.

IV. LIGJET KRYESORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Në vijim është paraqitur një përmbledhje dhe analizë e legjislacionit bazë që rregullon çështjet e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë.

- Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare - përcakton se shërbimet sociale në kuptimin e ngushtë, në Republikën e Kosovës janë të përfshira në sistemin e përkujdesjes sociale, me të cilin administrohet Ministria përkatëse për fushën e Shërbimeve Sociale dhe Familjare (MD). Në nenin 1 paragrafi 1.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare parashihet se: *“Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit apo në raste të veçanta, ndihmës materiale për njerëzit në nevojë sociale”*. Kjo do të thotë se përkujdesja sociale është veprimtari me interes të veçantë për Republikën e Kosovës, me të cilën sigurohet dhe realizohet ndihma për të plotësuar nevojat themelore jetësore për personat në nevojë sociale, në lidhje me:
 - a) Punët e shtëpisë;
 - b) Kujdesin personal;
 - c) Lëvizshmërinë;
 - d) Komunikimin dhe mbikëqyrjen.

Përkujdesja e përcaktuar në pikat më sipër, mund të ofrohet në shtëpinë e vetë personit, në një familje tjetër, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor apo në një institucion rezidencial.

Gjithashtu, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare përparësi eksplicite i jep shërbimeve në familje dhe komunitet, në raport me shërbimet e vendosjes në institucione. Në nenin 1 të këtij Ligji përcaktohet se: *“Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut”*. Ndërkaq, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t’u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit, e jo nëpër institucione rezidenciale.

Shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale definojnë si persona në gjendje nevojë (Neni 1). Në këtë grup bien personat të cilët kanë nevojë për shërbime sociale nga këto arsye:

- a) Fëmijë pa përkujdesje prindërore;
- b) Fëmijë me sjellje asociale;
- c) Delikuent i mitur;
- d) Fëmijë viktimë i marrëdhënieve të çrregulluara në familje;
- e) Person në moshë së shtyrë;
- f) Person me aftësi të kufizuara fizike;
- g) Person me aftësi të kufizuara mendore apo sëmundje psikike;
- h) Person i ekspozuar ndaj rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi;
- i) Person i ekspozuar ndaj dhunës në familje;
- j) Person i cili ka përjetuar trafikim me qenie njerëzore;

- k) person që është viktimë e varësisë nga alkooli ose drogat;
- l) person që ka pësuar humbje si pasojë e emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu; ose
- m) person që për ndonjë arsye tjetër, është në nevojë për shërbime.

Me nenin e njëjtë (neni 1) është përkufizuar edhe familja në nevojë: *“ku njërit ose të dy prindërve ose kujdestarit tjetër, i nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijë për shkak të gjendjes së fëmijës ose fëmijëve, ose në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore ose abuzimit nga ana e prindit ose prindërve të tij, ose për shkak të paaftësisë së prindit apo prindërve ose kujdestarit të tij që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose kur fëmija i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë.”*

Sa i përket të drejtave të shfrytëzuesve, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nuk specifikon të drejta sociale të veçanta ose të drejta në shërbime, siç i definojnë legjislacionet e shteteve në rajon, por thekson të drejtën në vlerësim. Kështu në nenin 1, pika 1.4 përcaktohet se: *“çdo person ose familje që e konsideron veten të jetë në nevojë sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë që t’i vlerësohen rrethanat nga Qendra për Punë Sociale e vendit ku jeton, ose në të cilin gjendet, dhe t’i plotësohen këto nevoja nëse është e arsyeshme që Qendra për Punë Sociale të veprojë kësisoj, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë shkallën e nevojës dhe ekzistimin e burimeve për përmbushjen e saj”*. Mirëpo, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare në mënyrë të hollësishme merret me çështjen e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të fëmijës, kurse pjesa për shërbimet për personat e rritur është mjaft e shkurtër. Në parim, neni 12 thekson se komuna, në bashkëpunim me familjet, komunitetet, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të parashikuara me ligj *“ofron përkujdesje sociale, këshillim, dhe në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit që kanë nevojë për shërbime sociale e që jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për shërbime të tilla dhe në mundësinë e komunës që t’i kryejë ato në mënyrë të arsyeshme”*.

Në kuptimin e gjerë, shërbimet sociale dhe familjare i gjejmë në sektorët komplementarë të përkujdesjes sociale. Këto shërbime, sikurse qëndron në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, janë të obliguara që të bashkëpunojnë me shërbimet e përkujdesjes sociale.

Ky Ligj përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë në Kosovë. Ky ligj parasheh rolin e Ministrisë përkatëse në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, më saktësisht rolin e Departamentit për Mirëqenie Sociale. Roli i këtij departamenti përfshin përgjegjësitë për drejtimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha funksioneve operative të përcaktuara me këtë ligj, që nga përgatitja dhe nxjerrja e rregulloreve, urdhëresave dhe udhëzimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Ky Ligj sipas nenit 5, ka krijuar Këshillin e Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe në këtë vazhde shërben si një organ regjistruar dhe licencues për profesionistët që punojnë në këtë lëmi. Neni 5, paragrafi 5.3 e bën Këshillin përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët janë të licencuar për ta ushtruar veprimtarinë në Kosovë. Neni 5, paragrafet 5.8 - 5.36 përcaktojnë strukturën, rregullimin dhe organizimin e brendshëm të Këshillit.

Neni 6 specifikon rolin e Komunës, paragrafi 6.1. i cili përmes drejtoratit të saj përkatës, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj, sipas standardit të specifikuar nga Ministria (roli dhe përgjegjësitë e secilës janë të cekura në nenin 2).

Ligji nr. 02/L-17 rregullon po ashtu shërbimet për fëmijë dhe familje (neni 9) - Mbrojtjen e fëmijëve duke i dhënë theks të veçantë interesit më të mirë të fëmijës, si në aspektin e përkujdesjes direkte dhe punës me fëmijët, ashtu edhe në aspektin e vendimmarrjes për fëmijën (neni 11). Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare rregullon edhe shërbimet për të rriturit në nenin 12, i cili parasheh që në bashkëpunim me familjet, komunitetet, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të parashikuara me ligj, komuna ofron përkujdesje sociale, këshillim, dhe në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit që kanë nevojë për shërbime sociale e që jetojnë në territorin e saj.

Mbrojtja e të rriturve në rrezik vihet në funksion kur ka dëshmi që një i rritur nuk është në gjendje të përkujdeset për veten për arsye të aftësive të kufizuara mendore ose është i lënë pas dore, i shfrytëzuar ose i abuzuar nga të tjerët për shkak të moshës, dobësisë ose aftësisë së kufizuar fizike dhe mendore (13.1).

- Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare - Zhvillimet e njëpasnjëshme, paraqitja e dukurive të reja, nevoja për një ligj të avancuar dhe të integruar ku paraqiten kompetenca të qarta për institucionet e nivelit qendror dhe lokal, bënë që Qeveria e Republikës së Kosovës të imponojë nevojën për të propozuar ndryshimin e Ligjit nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Ligji i ndryshuar përveç ndryshimeve në përkufizime dhe riformulimeve të disa prej neneve të Ligjit nr.02/L-17 në kuadër të nenit 11 të ligjit paraprak për Mbrojtjen e fëmijëve në rrezik, shtoi edhe nenet 11.A Mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale, si dhe nenin 11.B Mbrojtja dhe trajtimi i fëmijëve me sjellje asociale. Pas nenit 14 të ligjit bazik është shtuar neni i ri 14.A që parasheh Procedurat Ankimore. Ligji nr. 04/ L-081 shfuqizoi: Udhëzimin Administrativ nr. Nr. 1/2006 për themelimin dhe punën e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, Udhëzimin Administrativ Nr. 4/2006 për themelimin e komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në shkallën e dytë lidhur me shërbimet sociale dhe familjare, Udhëzimin Administrativ Nr. 5/2006 për themelimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim, Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2004 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë dhe Propozimin Nr.04/2005 për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2004 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligjit nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, por edhe ligjeve të tjera të lartpërmendura, bëhet nga Komisioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Rekomandimet nga ana e këtij komisioni janë bërë në vazhdimësi, ku edhe Ministri raportonin në vazhdimësi që ligji për shërbime sociale dhe plotësim ndryshimi i ligjit për shërbime sociale janë duke u zbatuar, mirëpo me qëllim të avancimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, Ministria përgjegjëse sipas Planit të Punës së Qeverisë, në vitin 2018 ka filluar me Draftimin e Koncept Dokumentit për rregullimin e fushës së shërbimeve sociale dhe familjare, i cili është planifikuar të aprovohet në periudhën Tetor-Nëntor 2018, ndërsa në vitin 2019 do të vazhdohet me draftimin e Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili edhe sot e kësaj dite në vitin 2023 nuk është aprovuar akoma.

- Ligji për Familjen i Kosovës - ky Ligj rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësimin), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.

Ligji nr.2004/32 për Familjen në kapitullin II, neni 5 për mbrojtjen sociale përcakton si në vijim: (1) Fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata me çrregullime mentale ose fizike të diagnostikuara, si dhe prindërit të cilët nuk janë të aftë të krijojnë kushtet e domosdoshme jetësore për vete dhe për fëmijët e tyre, janë nën përkrahjen e veçantë financiare dhe shoqërore. Neni 160 i këtij Ligji përkufizon dhe rregullon adoptimin. Ndërmjetësimi i adoptimit, autoriteti kompetent për adoptim (Gjykata), konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave, parimet e të adoptuarit, i adoptuari (të drejtat, detyrimet e tij), adoptuesi (kriteret, të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë), procedura, anulimi e deri tek efektet ligjore, janë ato që përfshihen në këtë ligj.

Pjesa e gjashtë e këtij ligji parasheh Kujdestarinë. Vendosja dhe qëllimi i Kujdestarisë: (1) Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike, (2) Qëllimi i kujdestarisë ndaj personave të moshës madhore është mbrojtja e personalitetit të tyre dhe do të manifestohet në radhë të parë me kujdes personal, aftësim për jetë të pavarur dhe me mjekim. (3) Kujdestaria ka për qëllim gjithashtu sigurimin e të drejtave pasurore, të të drejtave të tjera dhe interesave të personave nën përkujdesje. Kjo pjesë e këtij ligji përfshin: Kujdestarinë ndaj të miturve (kompetencat, procedurat, anulimi, etj.), kujdestarët për raste të veçanta, kompetencat ligjore në punët e kujdestarisë, kujdestari, pushtetet dhe procedurat.

Theksojmë se, duke qenë se edhe Ligji i Familjes është në rishikim së bashku me dispozitat mbi familjen në Projekt Kodin Civil, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet harmonizimit të veprimeve që merren në raport me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare me ato të Ligjit të Familjes dhe Projekt Kodit Civil, në veçanti çështjeve të mandatit të formave të mbrojtjes dhe shërbimeve që janë në të dy ligjet (Ligji i Familjes dhe Ligji i Shërbimeve Sociale dhe Familjare); ndërlidhjes me mandatin dhe funksionet e MD dhe MFPT në njërin anë dhe Komunave dhe QPS-ve në anën tjetër; rolit dhe përgjegjësi në zbatimin e shërbimeve; koordinimit ndërmjet institucioneve që ofrojnë shërbime; si dhe ndërlidhjes dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera, e në veçanti me ato të drejtësisë.

Ligji për Familjen i Kosovës, i cili është ligji bazik për fushën e të drejtës familjare, i cili përmban edhe dispozita materialo-juridike, por edhe dispozita proceduralo-juridike, duke i përcaktuar kompetenca dhe përgjegjësi më shumë se të gjitha ligjet e tjera për Organin e Kujdestarisë, ka shumë dispozita lidhur me organin e kujdestarisë, ku përcaktohet se:

“Neni 6

Mbrojta Institucionale e të drejtave

- (1) Punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t'i ushtrojë organi kompetent i administratës komunale i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale.*
- (2) Organi i Kujdestarisë është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale. Ai përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë.*
- (3) Organi i Kujdestarisë mundet gjithashtu të jetë organ (grup i ekspertëve siç është cekur më lart) i veçantë e institucionit social i themeluar nga Kuvendi Komunal për të kryer detyrat e tilla.*

(4) Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmarrë veprime të tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë, në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet”.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka Organi i Kujdestarisë brenda QPS-së edhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe ligjet e tjera materialo-juridike, përcaktojnë shumë detyrime për Organin e Kujdestarisë, e të cilat janë të njohura për secilin profesionist të shërbimeve sociale, andaj nuk do të trajtohen më shumë. Ajo që vlen të përmendet është edhe fakti se përveç ligjeve materialo-juridike, rëndësi të jashtëzakonshme Organit të Kujdestarisë i kushtohet gjithashtu edhe me ligjet procedurale, si: Ligji për Procedurën Jokontestimore, Ligji për Procedurën Kontestimore dhe ligjet e tjera që rregullojnë çështje të caktuara ku janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësit e Organit të Kujdestarisë.

- Ligji për Vetëqeverisje Lokale - Ky Ligj themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Fushëveprimi i këtij ligji: 2.1 Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunave dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale përcakton se përkujdesja sociale është radhitur në rrethin e punëve të vetëqeverisjes lokale. Në të vërtetë në nenin 17, paragrafi 1, nën paragrafi k) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale është përcaktuar se *komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, edhe në fushën e ofrimit të shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cenueshmit, strehimi familjar, përkujdesi fëmijëror, përkujdesi për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale.* Do të thotë se edhe me ligjin në fjalë, është vazhduar me decentralizimin e shërbimeve sociale dhe familjare duke i përcaktuar si kompetenca vetanake të komunave, si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Mirëpo, nëse kemi parasysh dispozitën e nenit 2 paragrafi 2.3 të Ligjit bazik për Shërbime Sociale dhe Familjare, me të cilën është përcaktuar se komunat apo organizatat e tjera qeveritare dhe jo qeveritare, përfshirë edhe ndërmarrjet private mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, por që, Ministria rezervon të drejtën që të përcaktojë ku, si dhe kush i kryen këto shërbime, ndërsa Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, gjithashtu si ligj bazik, ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare i konsideron si kompetenca vetanake, përkatësisht si kompetenca të plota dhe ekskluzive të komunës (Neni 17, paragrafi 1, nën paragrafi k), kjo tregon se dispozitat janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe se nuk është e qartë kryerja e shërbimeve sociale dhe familjare në fjalë. Kjo do të thotë se Ministria përkatëse për mirëqenie sociale edhe më tej mban ndikimin dominant në administrimin e tyre. Këtu shihet kolizionin e këtyre dispozitave ligjore.

Gjithashtu, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, krahas kompetencës vetanake të theksuar të komunave në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, në dispozitën e nenit 18 mbi kompetencën e deleguar, ka paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore të Republikës së Kosovës që në pajtim me ligjin, komunave tu delegojnë përgjegjësi edhe nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare lidhur me distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve) (neni 18, paragrafi 18.1, nën paragrafi e). Mirëpo, sipas paragrafit 18.2 të nenit 18, Ligji në fjalë, autoriteteve qendrore ua lë mundësinë që komunave, po qe se është e nevojshme dhe në pajtim me ligjin, t'u delegojnë kompetenca shtesë. Vlen të theksohet se në këtë ligj, ekziston dispozita, e cila ka paraparë se kompetencat e deleguara, në të gjitha rastet, duhet të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Paragrafi 18.3, i nenit 18 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale).

- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal - Bën përcaktimin e burimeve financiare të cilat janë në dispozicion të komunave në Kosovë, duke përfshirë të hyrat vetanake komunale, grantet dhe burimet e tjera financiare të nevojshme për ushtrimin e kompetencave komunale. Tek kompetencat vetanake ku përfshihen dhe ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, neni 4 i këtij ligji thotë: *"Parimi i paravarsisë financiare të komunave do zbatohet kundrejt financimit dhe zbatimit të kompetencave vetanake komunale; megjithatë, financimi dhe ushtrimi i këtyre kompetencave duhet të bëhet në të mirë të popullsisë së komunës dhe në përputhje me standardet dhe kushtet e aplikueshme për këto kompetenca të përcaktuara me ligj"*.

Ndërsa, neni 8 (Kategoritë e të hyrave vetanake të cilat janë burim i këtyre shërbimeve) vijon: *Të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar nga komuna në bazë të autorizimit të një ligji nga burimet në vijim, janë të hyra vetanake të komunës: a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuara në bazë të këtij ligji;* Neni 24 parasheh burimin tjetër të financimit të këtyre shërbimeve (Granti i Përgjithshëm) 24.1 Komunitetet kanë të drejtë të pranojnë një Grant të Përgjithshëm të cilin mund ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Granti i Përgjithshëm (i) mundëson një shkallë të arsyeshme të stabilitetit në të hyrat komunale, (ii) ofron një mjet adekuat për vendosjen e barazisë ndërmjet komunave, (iii) duke marrë parasysh mundësinë e banorëve të secilës komunë për të pasur qasje në shërbimet publike, dhe (iv) mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitetet pakicë në komunat përkatëse. Granti i përgjithshëm është grant i tipit të mbyllur me 10% të të hyrave të projektuara që do të duhen të mbledhen në nivel qendror gjatë një viti kalendarik. Mirëpo problemi për shërbime sociale fillon pikërisht këtu, sepse kjo formë nuk ofron garanci që do të ketë ndarje të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale. Kjo sepse nga këtu nuk ka ndonjë mekanizëm apo formulë financimi të ndarjes për shërbimet sociale, duke ditur se nga këto shuma buxhetojnë të gjitha departamentet për shpenzimet operative dhe kapitale. Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në mëshirë të vullnetit të nivelit komunal (duke pasur parasysh financimin e pamjaftueshëm në vitet e fundit), është sugjeruar të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e financimit brenda Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, përmes krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës Nr. 06/L-084 – përveç dispozitave të tjera me të cilat avancohet mbrojtja e të drejtave të fëmijës, përcakton detyrimin për themelimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve me vetë dispozitën e nenit 30, par. 1 ku përcaktohet se: *"Me këtë ligj themelohen shtëpitë për mbrojtje"*.

jtjen e fëmijëve, nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale pranë Qendrave për Punë Sociale përkatëse ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore". Nga kjo dispozitë ligjore shihet se vetë ligji në fjalë ka themeluar shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës dhe jo rastësisht ligjvënësi përdor shumësin, pasi që duhet të themelohen disa shtëpi për mbrojtjen e fëmijëve të kategorive të ndryshme. Këto shtëpi themelohen në të gjitha regjionet e Kosovës ku ka Gjykata dhe Prokurori (7 regjione).

Sipas nenit 30 paragrafi 2, organ kompetent për përcaktimin e standardeve dhe miratimin e themelimit të shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve është Ministria përkatëse.

V. KORNIZA LIGJORE NË KOSOVË QË RREGULLON KONTRAKTIMIN / KOMISIONIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE

Korniza ligjore në Kosovë që rregullon kontraktimin / komisionimin e shërbimeve sociale është e rregulluar parçialisht me shumë dispozita në ligje të ndryshme, por gjithsesi në mënyrë të pamjaftueshme. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare siç është plotësuar dhe ndryshuar, krijon bazën kryesore juridike jo vetëm për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, por edhe bazën ligjore për kontraktim të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur organet shtetërore që janë përgjegjëse për ofrimin e këtyre shërbimeve, nuk kanë mundësi dhe kapacitete të brendshme për ofrimin e tyre. Ky Ligj përcakton decidivisht mundësinë e kontraktimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga OJQ-të. Bazuar në nenin 8, paragrafi 4, krijohet mundësia që edhe komunat të lidhin kontrata me organizatat jo qeveritare për ofrimin e shërbimeve sociale brenda territorit të tyre, sipas nevojave dhe planifikimeve të tyre. Gjithashtu neni 8, paragrafi 5 i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton kompetencën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministrisë së Drejtësisë për kompetencat e bartura, e cila autorizohet me ligj që të japë fonde dhe të ofrojë çfarëdo ndihme tjetër materiale, për organizatat jo qeveritare që ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare në nivel të Republikës së Kosovës, përmes procedurave të komisionimit dhe kontraktimit. Këtu shihet se është bërë një lëvizje ligjore në drejtim të rregullimit të veçantë të fushës së shërbimeve sociale dhe lejitimit të kontraktimit të tyre, por ajo që është problem këtu ka të bëjë me atë se nuk gjinden dispozita ligjore procedurale, gjë e cila e pamundëson zbatimin e tyre ndaras nga prokurimet e tjera, andaj paraqiten pengesa evidente. Po ashtu, pa ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik dhe krijimin e mirëfilltë të bazës juridike për rregullimin e fushës së komisionimit dhe kontraktimit të shërbimeve sociale, nuk mund të themi se është rumbullakësuar në aspektin ligjor kjo fushë.

Në linjën e njëjtë të tentativave për hapjen e mundësive për kontraktimin e OJQ-ve për ofrim të shërbimeve sociale është edhe tentativa e bërë me ligjin Nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, me të cilin organizatave të shoqërisë civile i është mundësuar që të konsiderohen operator ekonomik për qëllim të ligjit të Prokurimit Publik, e që është një hap shumë i rëndësishëm në zhvillimin e këtij sektori, pasi që OJQ-të mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik krahas subjekteve të tjera juridike dhe ekonomike, meqenëse kanë marrë statusin e operatorit ekonomik.

Gjithashtu, po kaq i rëndësishëm është edhe Neni 132/A "Kontraktimi i shërbimeve nga OSHC", dispozitë kjo e cila është shtuar në ligjin për Prokurim Publik që nga viti 2016, i cili përcakton se: *Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.* Kjo dispozitë krijon bazën ligjore për Qeverinë e Republikës së Kosovës për rregullimin e procedurave të prokurimit për OJQ-të që kanë të bëjnë me kontraktimin e shërbimeve në përgjithësi, por që ky akt nënligjor nuk është nxjerrë dhe rrjedhimisht kjo dispozitë ligjore ka mbetur jo funksionale, pasi që nevojitet zberthimi i saj përmes aktit nënligjor të Qeverisë për rregullimin e procedurave specifike, vetëm për kontraktimin e shërbimeve me OJQ-të.

Në funksion të kontraktimit të shërbimeve sociale janë edhe disa Udhëzime Administrative, me anë të të cilave është zhvilluar dhe konsoliduar dukshëm edhe gama e organizatave, personave fizik dhe juridik të cilët mund të ofrojnë shërbime sociale, duke ju nënshtruar një procedure strikte të plotësimit të kriterëve dhe licencimin e tyre. Një akt i tillë nënligjor me shumë rëndësi është edhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për licencimin e organizatave jo qeveritare dhe subjekteve juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, por kontraktimi i këtyre shërbimeve duhet të rregullohet mirëfilli me norma juridike në ligjet e lartpërmendura, dhe aspekte procedurale pastaj mund të specifikohen edhe me Udhëzim Administrativ.

Megjithatë, edhe përkundër ekzistimit të disa akteve juridike, që në një formë apo tjetër hapin mundësi për rregullimin e fushës së kontraktimit të shërbimeve sociale, nevojitet që dispozitat ligjore të jenë akoma më të qarta në këtë drejtim, në momentin kur të bëhet rishikimi i tyre, gjë e cila shihet se është imperativ i kohës.

Detyrimet e shtetit për mbrojtjen juridike, sociale dhe familjare të personave në nevojë, është i përhershëm dhe tashmë fusha e prokurimeve publike ka një traditë afërsisht dy dekada të rregullimit ligjor në Kosovë, që nga pas lufta. Megjithatë, blerja e shërbimeve sociale jashtë rregullave të Ligjit për Prokurim Publik ka qenë e pamundur dhe nuk është zbatuar deri më tani.

Në funksion të kësaj ka një udhëzim të BE-së mbi prokurimin publik¹⁰, i cili lejon disa përjashtime nga rregullorja e prokurimit të përgjithshëm në rastin e shërbimeve shëndetësore apo sociale. Për ta nuk është i rëndësishëm përdorimi i mekanizmit të prokurimit publik, por përdorimi i një mekanizmi tjetër që reflekton më mirë kushtet specifike që lidhen më këto shërbime. Gjithsesi, nëse vlera e kontratave të tilla tejkalon një limit minimal, procedura të paktën duhet të sigurojë që është transparente dhe që të gjithë operatorët ekonomik trajtohen në mënyrë të barabartë¹¹.

Me fjalë të tjera, BE lejon që shërbimet sociale të kontraktohen jo duke përdorur mekanizmin e prokurimit publik, por duke dizenuar një mekanizëm të veçantë që mund të jetë më i thjeshtë dhe që merr në konsideratë specifikat e shërbimeve sociale dhe ofruesit potenciale të tyre.

VI. AKTET NËNLIGJORE KRYESORE, ME TË CILAT RREGULLOHET FUSHA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Disa nga aktet më të rëndësishme nënligjore në fushën e shërbimeve Sociale dhe familjare	Lidhja me aktin në Gazetën Zyrtare	Institucioni/et shtetëror/e përgjegjës/e për zbatim, pas bartjes së kompetencave për fushën e shërbimeve sociale dhe familjare në vitin 2023	Qëllimi
1. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2020 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Nivelin Bazik, të Mesëm dhe të Lartë	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave të licencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare të nivelit bazik, të mesëm dhe të lartë, përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet t'i plotësojnë ofruesit e shërbimit social dhe familjar për licencim në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe organizimin dhe funksionimin e komisioneve që zbatojnë dhe vendosin në procedurën e licencimit.
2. Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare	GZRK	MD	Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen procedurat e aplikimit, kushtet dhe kriteret që duhet t'i plotësojnë organizatat jo qeveritare si dhe subjektet juridike private për t'u licencuar në ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare, organizimin dhe funksionimin e komisioneve që e zbatojnë dhe e vendosin procedurën e licencimit, dhënien, refuzimin, ripërtërijen dhe tërheqjen e licencës, llojet e licencave, procedurën e ankesës dhe pagesën e taksës për licencim.
3. Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr. 03/2020 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Nivel Profesional	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin e procedurave të licencimit, kushtet dhe kriteret që duhet t'i plotësojnë ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, në nivel profesional, organizimin dhe funksionimin e komisioneve që zbatojnë dhe vendosin në procedurën e licencimit, si dhe përcaktimin e shumës së taksës për licencim.

4. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që në mënyrë unike dhe standarde të rregullojë procedurat dhe procesin e vendosjes së fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar, në rastet kur qëndrimi në familjen biologjike është i pamundur. Po ashtu, ky Udhëzim Administrativ qartëson veprimet dhe aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kësaj forme të mbrojtjes në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë dhe çështjen e kompensimit material.
5. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 08/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshim/plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë.
6. Rregullore (MPMS) Nr. 2/2015 për Kriteret dhe Procedurat e Përkrahjes Financiare për Subvencione dhe Grante	GZRK	MD	Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përkrahjes së personave fizik që kanë nevojë për ndihmë financiare dhe mbështetjen e personave juridik (OJQ-të dhe ndërmarjet) që ofrojnë shërbime dhe zbatojnë projekte në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale.
7. Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr. 09/2014 për Rregullimin e Procedurave të Adoptimit të Fëmijëve pa Përkujdesje Prindërore	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave të adoptimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Familjen të Kosovës, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare me plotësimet dhe ndryshimet e tij, Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe konventës së Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe adoptimin lidhur me bashkëpunimin ndërshtetëror.
8. Udhëzim Administrativ Nr. 11/2014 për Punën dhe Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të Zvogëluara Mendore – Ngecje në Zhvillimin Mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ përcakton punën, rregullat dhe kriteret për vendosjen e personave me aftësi të kufizuara mendore, ngecje në zhvillimin mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet në Republikën e Kosovës.

<p>9. Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 14/2013 për Monitorimin dhe Inspektimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare</p>	GZRK	MD	<p>Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen procedurat e monitorimit dhe inspektimit, kushtet, kriteret dhe standardet që duhet t'i plotësojnë subjektet juridike/organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, organizimi dhe funksionimi i komisioneve që e zbatojnë dhe e vendosin procedurën e monitorimit dhe inspektimit, llojet e inspektimit, procedurat e ankimimit, mënyrën e monitorimit dhe inspektimit, përgatitjen dhe përpilimin e raportit lidhur me rezultatet e monitorimit dhe inspektimit, si dhe propozimin e masave të parapara me Ligj.</p>
<p>10. Udhëzim Administrativ Nr. 12/2012 për Përbajtjen dhe Funksionimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa Kujdes Prindëror në Strehim</p>	GZRK	MD	<p>Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave për themelimin, përbërjen dhe funksionimin e Panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe adoptim, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisve të këtij Paneli.</p>
<p>11. Udhëzim Administrativ Nr. 10/2012 për Organizimin, Fushëveprimin dhe Funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare</p>	GZRK	MD	<p>Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që në mënyrë unike dhe standarde të rregullojë dhe organizojë fushëveprimin dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, si dhe ta mandatojë atë si organ për mirëmbajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe si licencues për profesionistët që punojnë në këtë fushë.</p>
<p>12. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2011 për Përcaktimin e Procedurave pas Bartjes së Përgjegjësive të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Nivelin Komunal</p>	GZRK	MD	<p>Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen procedurat e zbatimit të legjislacionit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin lokal, nëpër të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, pas bartjes së përgjegjësive nga niveli qendror në nivelin lokal, sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Financave (MF) dhe komunave të Kosovës.</p>

13. Udhëzim Administrativ Nr. 03/2011 për Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale, pa Përgjegjësi Penale dhe Atyre me Sjellje Asociale	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ rregullon mënyrën e mbrojtjes dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave pa përgjegjësi penale, dhe fëmijëve me sjellje asociale nga ana e organit të kujdestarisë, dhe punën e organizatave joqeveritare që kanë ekspertizë profesionale për trajtimin e kësaj kategorie. Në procedurën e trajtimit dhe të mbrojtjes së fëmijës, konsiderata e parë dhe më e rëndësishme është mbrojtja e interesave të tij.
14. Udhëzim Administrativ Nr. 07/2011 për Punën dhe Kriteret e Vendosijes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpinë me Bazë në Komunitet	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat dhe kriteret për vendosjen e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare në SHPMPF në Prishtinë dhe në shtëpitë me bazë në komunitet në Republikën e Kosovës.
15. Udhëzim Administrativ Nr. 01 /2010 për Procedurat për Delegimin e Përgjegjësive për Skemën e Ndihmave Sociale në Nivelin Komunal	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave, pas delegimit të përgjegjësive për Skemën e Ndihmës Sociale (SNS) nëpër komunat e Republikës së Kosovës, që ka ndodhur sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar në muajin janar 2009, në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe komunave, për delegimin e përgjegjësive për Skemën e Ndihmave Sociale në nivelin komunal.
15. Udhëzim Administrativ Nr. 10/2010 për Ofrimin e Shërbimeve në Komunitet-Shtëpi për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ rregullon fushëveprimtarinë në sferën e ofrimit të shërbimeve, përkujdesjes sociale në komunitet-shtëpi, për personat e moshuar dhe pa përkujdesje.
16. Udhëzim Administrativ Nr. 13/2010 për Ofrimin e Shërbimeve në Komunitet-Shtëpi për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore, Ngecje në Zhvillim Mendor	GZRK	MD	Ky Udhëzim Administrativ rregullon fushëveprimin në sferën e ofrimit të shërbimeve, përkujdesjes sociale në komunitet-shtëpi, për persona me aftësi të kufizuara mendore (ngecje në zhvillim mendor) fizik dhe të kombinuara.

ANEKSET

A) Raste studimi

Rast për modulin trajnues: Legjislacioni i Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Ylli nga Prishtina, ka qëndruar në strehim familjar jashtë farefisit. Ai ka qenë fëmijë pa përkujdesje prindërore, pasi prindërit e tij kishin humbur jetën në një aksident komunikacioni vite më parë.

Në momentin e arritjes së moshës 18 vjeçare, institucionet përkatëse të nivelit lokal dhe qendror kanë ardhur në përfundim se me arritjen e moshës madhore nuk lejohet vazhdimi i pagesave për strehim familjar, pasi që këtë nuk e lejon Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe as Udhëzimi Administrativ që rregullon këtë fushë.

Ndërkohë që Ylli është duke ndjekur studimet në drejtimin juridik dhe ka dëgjuar dhe mësuar se ka instrumente juridike ndërkombëtare që rregullojnë të drejtat e personave në nevojë, përfshirë edhe ata që janë të moshës madhore dhe në shkollim universitar, sikurse është edhe Ylli. Me këtë rast ai i drejtohet institucioneve përkatëse për vazhdimin e mbështetjes financiare për strehim familjar të paktën deri në përfundim të studimeve duke u thirrur se këtë të drejtë ja mundësojnë aktet juridike ndërkombëtare, por pa specifikuar asnjë nen dhe as emrin e aktit në fjalë.

Ju si profesionist i shërbimeve sociale cilat veprime do t'i ndërmerri?

Nëse Kushtetuta është në kundërshtim me ndonjë prej instrumenteve ndërkombëtare, cilën dispozitë do ta aplikoni, atë të Kushtetutës, apo dispozitat e Konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare?

Nëse legjislacioni primar dhe sekondar është në kundërshtim me dispozitat e konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare të listuar në Kushtetutën e Kosovës, cilën prej dispozitave do ta zbatoni dhe do t'i jepni përparësi në këtë rast, dhe si do ta arsyetoni për të mos bërë shkelje ligjore nëse e apro-voni, e gjithashtu për të mos bërë shkelje të të drejtave të njeriut nëse kërkesën e tillë do ta refuzoni?

Pas analizimit të rastit, ju lutem që në mënyrë të detajuar të përshkruani dhe prezantoni statusin e Yllit.

Çka do të ndodhë me të dhe cilat janë veprimet që duhet t'i ndërmerri në rastin konkret për të mbrojtur të drejtat të cilat i garantohen Yllit sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës, nëse ka të drejtë, apo si do ta arsyetoni refuzimin e kërkesës së tij?

B) Agjenda

MODULI: LEGJISLACIONI I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Dita e parë	
09:00 - 09:30	Qëllimi, objektivat dhe pritjet e pjesëmarrësve
09:30 - 10:30	Sesioni i parë: Shqyrtime të përgjithshme rreth kornizës ligjore në Kosovë për fushën e shërbimeve sociale dhe familjare
10:00 - 10:30	Sesioni i dytë: Instrumentet ndërkombëtare
12:15 - 13:15	Dreka
13:00 - 14:00	Punë në grupe / raste studimi
14:00 - 14:30	Prezantim i detyrave
15:30 - 16:00	Reflektime dhe përmbyllja e ditës së parë

Dita e dytë	
10:00 - 12:00	Sesioni i tretë: Udhëzimet Administrative nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare Sesion plenar dhe ndarje e praktikave
12:00 - 13:00	Dreka
13:00 - 14:00	Punë në grupe / raste studimi
14:00 - 14:30	Prezantim i punës në grupe
14:45 - 15:00	Refektim mbi njohuritë e marra
15:00 - 15:30	Vlerësim i trajnimit dhe përmbyllje

C) Burimet e referimit

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>)
- Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735715-Pakti-Drejtat-Ekonomike-Sociale-Kulturore.pdf>
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>
- Karta Europiane Sociale <https://rm.coe.int/168047e169>
- Korniza Europiane Vullnetare e Cilësisë për Shërbimet Sociale <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1169&langId=en>
- Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/united-nations-guidelines-alternative-care-children>
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-064). <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>
- Ligji nr. 02/I-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>
- Ligji nr. 04/I-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/I-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2808>
- Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>
- Ligji nr. 03/I-040 për Vetëqeverisjen Lokale <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>
- Ligji nr. 03/I-049 për Financat e Pushetit Lokal <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2525>

Udhëzimet Administrative të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e të cilat bazën juridike për nxjerrjen e tyre e kanë në Ligjin bazë për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe në Ligjin për Plotësimin dhe ndryshimin e tij, e të cilat janë të listuara si më sipër.

D) Vlerësim trajnimi

Shënim: Ky vlerësim është anonim. Do të shërbejë për të bërë rregullimet e nevojshme dhe për të avancuar më tej programin e trajnimit. Luteni të shfrytëzoni kohën e nevojshme dhe të na jepni komentet tuaja të vlefshme.

1. Aspektet logjistike	Jo	Nganjëherë	Shumicën e kohës	Po, plotësisht
1.1 Unë jam informuar me kohë për datën e punëtorisë				
1.2 Vendi i takimit ishte i rehatshëm dhe ipër-shtatshëm për aktivitetet e trajnimit				
1.3 E kam pranuar me kohë agjendën e punëtorisë				
2. Trajneri, efikasiteti dhe efektiviteti	Jo	Nganjëherë	Shumicën e kohës	Po, plotësisht
2.1 Trajneri ka prezantuar qëllimin dhe rezultatet e pritura të modulit të trajnimit				
2.2 Trajneri ishte kompetent në fushat përkatëse				
2.3 Trajneri kontribuoi në pjesëmarrjen aktive të të trajnuarve				
2.4 Prezantimet ishin të elaboruara dhe të qarta				
2.5 Trajneri ofroi shembuj të mjaftueshëm dhe të duhur në ilustrimin e përmbajtjes				
2.6 Trajneri aplikoi metodainter-aktive të trajnimit				
2.7 Vëmendje e veçantë iu kushtua punës në çifte, në grupe ose punës individuale				
2.8 Trajneri ofroi përgjigje adekuate për pyetjet e ngritura nga pjesëmarrësit				
2.9 Trajneri ofroi komente adekuate për prezantimet e punës në grupe /punës individuale / ose punës në çifte				
3. Përshtypjet e përgjithshme	Jo	Nganjëherë	Shumicën e kohës	Po, plotësisht
3.1 Jam i kënaqur me cilësinë e përgjithshme të trajnimit.				
3.2 Trajnimi ka përmbushur rezultatet e pritura				
3.3 Do t'i përdor materialet që janë shpërndarë për punën time pasuese				
3.4 Trajnimi kishte ekuilibër të duhur të aspekteve teorike dhe praktike				

Luteni t'i përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat tema ishin në interesin tuaj më të madh?
- Cilat tema ishin më pak të rëndësishme për ju?
- Çfarë ndryshimesh do të rekomandonit në këtë program të trajnimit?
- A keni ndonjë koment tjetër?

